



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

Nr. 14-020/04-78467, më 06 JUN 2016

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë

**V E N D I M**

**Për caktimin e anëtarit në Komisionin Komunal të Aksionarëve për  
NPL " Sport Marketing" SH.A**

1. Arben Kqira, caktohet anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale të Kryeqytetit " Sport Marketing" SH.A.
2. Anëtari i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi së bashku me 2 (dy) anëtarët të cilët i emëron Kuvendi i Kryeqytetit e përbëjnë Komisionin Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale të Kryeqytetit " Sport Marketing" SH.A.
3. Anëtari i Komisionit Komunal të Aksionarëve i caktuar me këtë Vendim, ka të drejtë të veproj në emër të Kryetarit të Kryeqytetit.
4. Veprimet e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve duhet të jenë në përputhje me Ligjin përkatës për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit përkatës për Shoqëritë Tregtare.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

**I DORËZOHET:**

- Anëtarit z. Arben Kqira;
- NPL " Sport Marketing" SH.A;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
Përparim Rama

